

# ANKIM NË KAS

DREJTUAR: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS)

SUBJEKTI ANKUES: Z. Shkëlqim Malevija

E-mail kontakti: shkelqim\_malevija@yahoo.com

## Objekti i ankimit:

Kundërshtimi i Vendimit nr. 1293, datë 19.05.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për pushimin e shqyrtimit të denoncimit nr. 175 ID, datë 07.05.2025, për shkelje të ligjit gjatë fushatës zgjedhore dhe mosreferimin e rastit në organet e ndjekjes penale.

## Kërkojmë:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 1293, datë 19.05.2025, për shkelje të afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 145 të Kodit Zgjedhor;
2. Rishqyrtimin e denoncimit nr. 175 ID dhe marrjen e një vendimi të arsyetuar ligjërisht;
3. Verifikimin e mosveprimit të Komisionerit për kallëzim penal, në kundërshtim me nenin 16 të Kodit Zgjedhor;
4. Marrjen e masave për cenimin e të drejtës për ankim efektiv dhe në kohë, për shkak të vonesës në vendimmarrje;
5. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit për mungesë arsytimi dhe për përfshirjen e gabimeve materiale të rënda, si përmendja e Bashkisë Pogradec në vend të Bashkisë Shkodër.

## Arsyetim i detajuar:

- Denoncimi është paraqitur më datë 07.05.2025, ndërsa vendimi është marrë më 19.05.2025, duke tejkaluar afatin ligjor 5-ditor të përcaktuar në nenin 145/3 të Kodit Zgjedhor.
- Vendimi është pa asnjë arsyetim juridik ose faktik dhe nuk shqyrton në asnjë pikë provat e paraqitura, si videot, dokumentet, komunikimet apo faktet që mbështesin shkeljen e nenit 88 dhe 91 të Kodit Zgjedhor.
- Komisioneri ka detyrimin ligjor që, nëse evidenton elementë të një vepre penale gjatë shqyrtimit administrativ, ta referojë çështjen në Prokurori ose SPAK, çka nuk është bërë, në kundërshtim me nenin 16 të Kodit Zgjedhor.
- Në tekstin e dokumentacionit administrativ të përgatitur nga Komisioneri është përfshirë një gabim thelbësor, ku thuhet se pretendimet janë marrë nga 'Bashkia Pogradec', ndërkohë që çështja i përket territorit të Bashkisë Shkodër. Ky gabim përbën mangësi serioze që kompromenton integritetin dhe saktësinë e shqyrtimit administrativ.

5. Janë dërguar prova shtesë me e-mail më datë 11 dhe 13 maj 2025, të cilat nuk janë marrë në konsideratë ose nuk janë përmendur në vendim, duke krijuar mungesë transparence dhe paplotësi të hetimit administrativ.

**Bashkëngjitur këtij ankimi:**

- Vendimi i Komisionerit nr. 1293, datë 19.05.2025;
- Denoncimi fillestar i datës 07.05.2025;
- Provat shtesë të dërguara me e-mail më datë 11 dhe 13 maj 2025;
- Komunikimet zyrtare për ndjekjen e procedurës dhe mungesën e përgjigjes brenda afatit;
- Materiale filmike dhe referenca në rrjetet sociale që provojnë promovimin zgjedhor;
- Kopje e segmentit ku në dokument përmendet gabimisht Bashkia Pogradec në vend të Bashkisë Shkodër.

Me respekt,

Shkëlqim Malevija

shkelqim\_malevija@yahoo.com

Shkodër, më 22 maj 2025

**Shkelqim  
Malevija**

Digitally signed by  
Shkelqim Malevija  
Date: 2025.05.22  
14:34:02 +02'00'



# D E N O N C I M

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Subjekti i denoncuar: Z. Benet Beci (Kandidat për Kryetar Bashkie, Shkodër) dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH)

Objekti i denoncimit: Shkelje e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe legjislacionit në fuqi për ndërtime publike gjatë periudhës zgjedhore, përmes promovimit dhe zbatimit të një investimi publik pa leje ndërtimi, me qëllim përfitime elektorale.

## Përshkrimi i fakteve:

1. Dyshojmë se është projektuar, po ndërtohet dhe po nxitet ndërtimi i rrugës "Harku i Berdicës – Ura e Bahçallekut" pa leje ndërtimi të lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT), në kundërshtim me nenin 39 dhe 52 të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", si dhe në kundërshtim me nenin 91 pika 1 dhe 2 dhe nenin 88 të Kodit Zgjedhor që ndalon promovimin dhe realizimin e investimeve publike gjatë fushatës zgjedhore për qëllime elektorale.

2. Projekti është hartuar në shtator 2024, pa ndjekur procedurat ligjore të tenderimit, por me anë të një marrëveshjeje direkte me Universitetin Politeknik të Tiranës, gjë që krijon dyshime të arsyeshme për shmangie të qëllimshme të procedurave për të mundur fillimin e punimeve para zgjedhjeve.

3. Kontrata për zbatimin e punimeve është lidhur në datën 18 dhjetor 2024, dhe punimet kanë nisur në janar 2025 pa pasur një leje ndërtimi të miratuar nga KKT, çka përbën shkelje të rëndë ligjore dhe administrative.

4. Në terren janë ndërmarrë veprime të tilla si prishje trotuareve dhe ndërhyrje në pronë private, duke ngritur kantier ndërtimi pa leje të ligjshme - veprime që dëshmojnë nxitimin për të paraqitur volum pune në prag të zgjedhjeve.

5. Që prej 19 shkurtit 2025, një grup banorësh ka kërkuar me shkresë zyrtare pranë ARRSH-së informacion për lejen e ndërtimit, projektin, listën e shpronësimeve, por nuk ka marrë ende përgjigje. Bashkia Shkodër i ka referuar qytetarët te ARRSH, ndërsa Prefektura nuk ka reaguar. Ky mosreagim institucional forcon dyshimet se investimi po kryhet në mungesë të dokumentacionit të rregullt ligjor.

6. Z. Benet Beci, më datë 16 prill 2025, në orën 12:26, ka publikuar në faqen e tij zyrtare në Facebook një video ku promovon këtë investim, megjithëse ekzistojnë dyshime serioze se projekti nuk ka leje ndërtimi. Kjo përbën shkelje të nenit 91 pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe të ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Kodit të Sjelljes Administrative.

7. Sipas grafikut të punimeve, ndërtimi i urës duhet të kishte filluar, por kjo nuk ka ndodhur – gjë që përflitet se lidhet me mungesën e lejes së ndërtimit dhe pamundësinë e një firme të huaj për të punuar në një kantier pa dokumentacion të rregullt.

8. Gjatë punimeve për ndërtimin e rrugës në fjalë, ARRSH ka ndërhyrë në trotuare që janë në pronësi të Bashkisë Shkodër. Nuk ka asnjë të dhënë publike apo dokument zyrtar që dëshmon se këto trotuare i janë kaluar ARRSH-së me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB), siç kërkohet nga ligji për administrimin e pronës publike dhe nga ligji për vetëqeverisjen vendore. Ky veprim përbën një ndërhyrje të paligjshme në pronën e një institucioni tjetër, duke cenuar kompetencat e Bashkisë dhe duke ngritur dyshime për abuzim me qëllim përfitime elektorale.

#### **Bazuar në sa më sipër, kërkojmë:**

- Hetim të plotë nga KQZ-ja dhe SPAK për këtë rast, për shkelje të nenit 91 dhe 88 të Kodit Zgjedhor .
- Verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga ARRSH për këtë projekt.
- Marrjen e masave ndaj z. Benet Beci dhe ARRSH-se për përdorim të mundshëm të burimeve publike për përfitime elektorale.

#### **Bashkëngjitur:**

- Fotokopje e kërkesës drejtuar ARRSH
- [https://www.facebook.com/beci.benet/videos/1387382565618532?locale=sq\\_AL](https://www.facebook.com/beci.benet/videos/1387382565618532?locale=sq_AL) ( 16 prill 2025)
- [https://www.facebook.com/beci.benet/videos/1139548804529015?locale=sq\\_AL](https://www.facebook.com/beci.benet/videos/1139548804529015?locale=sq_AL) ( 11 Shkurt 2025)
- <https://azht.gov.al/>)
- <https://openprocurement.al/sq/arsh/vieë/id/487>

← Back

Archive

Move

Delete

Spam

...

⌵

⌵

⌵

⌵



Shkelqim Malevija

From: shkelqim\_malevija@yahoo.com

To: denoncime

Cc: Pavlina Docaj, Ina Horanliu



Sun, May 11 at 4:59 PM



Pershendetje te nderuar,

Ne kuader te denoncimeve te dates 3 Maj 2025, 6 Maj 2025 dhe 7 Maj 2025... te identikuara me nr 17510  
Po ju dergojme dhe prova te tjera shlese, per parregullsine dhe paligshmierine e punimit qe eshte not, dhe po realizohet nga Kryetari Benet  
Beci dhe nga Partia Socialiste vetem per efekt elektoral duke bashkepunu si grup i organizuar Bashki, PS, ARRSH, IMT, IKMT, Inspektorat  
Shtetor i Punes, Bashkimi i Operatorve qe po kryejne punimet sepse me ose mosveprimet e tyre kane bere deme te medha ekonomike te  
prones publike dhe private... nepermjet korupsionit pasiv kane lejuar dhe kane vazhduar duke be shkelje te randa ligjore  
1. ARRSH ben ndertime pa leje ne Shkoder/ Bashkia hesht perball shqetesimit te qytetareve



ARRSH ben ndertime pa leje ne Shkoder/  
Bashkia hesht perball shqetesimit...


Programi investigativ piranja ku konfirmohet se investimi eshte pa LEJE NDERTIMI !!!

- Gjeje 4 Muajve te filim Vibri Kryeministri dhe Kryetari i Partise Socialiste ne vizuar Shkodren mbi 6 here dhe asnjeher nuk eshte ndalur tek  
nje investim... qe ka kosto 10 milion euro + 3 milion shpernesime (pensefshiti te ligjortura) me mjafti ne 12 vitet per qytetin e  
Shkodres... pse ??? Pse nuk kane bere asnje takim me kryetarin PS pa leje hata, berudhe ??? por ka preferuar qe nepermjet video dhe  
materialeve te shpendara... te prek shume qytetar te rakundur ne votime me ne probet qe eshte ne shkelje te plote me ligjin

Mbesin ne pritje te ecurise se investigimeve

Finni per bashkepunimin!

X Zoti qe jeta me shpirt



Archive Move Delete Spam ...



Kerkesa pe... .docx  
24.8



Kerkesa pe... .docx  
24.8



**Shkelqim Malevija**

From: shkelqim\_malevija@yahoo.com

To: Ina Horanliu, Kqz Gov Info

Cc: Pavlina Docaj

Thu, May 22 at 1:31 PM ☆

Pershendetje te nderuar,

Ne mbeshetja te nenin 145 te kodit Zgjedhor. Komisiona duhet te kshhte marre nje Vendim te Arsyuar brenda 5 Diteve. Kane kaluar 15 dite dhe akoma nuk kemi nje vendimarrje ???!!

Ju lutem a mund te na sqaroni arsyen ?

Filmin

[Show original message](#)



**Shkelqim Malevija**

From: shkelqim\_malevija@yahoo.com

To: Info KQZ, Ina Horanliu

Cc: Pavlina Docaj

Thu, May 22 at 1:33 PM ☆

Pershendetje

...duhet te kshhte nje vendim marre dhe deklaruar brenda 5 dite nga koha kur ka qene ...



**Shkelqim Malevija**

From: shkelqim\_malevija@yahoo.com

To: Denoncime, Pavlina Docaj, Kqz Gov Info



Wed, May 7 at 1:24 PM ☆

### Pershendetje

Ne pamundes per ta hedh ne portal  
po ju ridergojme denoncimin e n per Partine Socialiste Shkoder dhe Kryetarin e Bashkise Shkoder Benet Beci.

Kodi Zgjedhor ( nenit 91 Pika 1 dhe Pika 2, Neni 88, pika e nadlimit dhe promovimit e investimeve publike gjate fushates per qellime  
elektorale, ligji per Planifikimin dhe dhe Zhvillimin e termitont Neni 39, Neni 52, Ligji per Parandalimin e Konfliktit te Interesave, ) ku nje zyrtar  
nuk lejohet te perdor pozicion e tij ne favor te subjektit zgjedhor, si kod i Sjelljes Administrative hde akte nenligjore per etikën ne  
administraten publike.

Nxitje dhe Promovimi i puneve publike pa leje ndertim, per efekte zgjedhore. Ne Videon e publikuar nga Benet Beci kryetar i bashkise  
Shkoder ne videoklipin e realizuar per spotin e kandidatëve nga 0-5 sekondat e pare ne sfond jane punimet pa leje qe po kryhen per  
segmentin Ura e Bahcallekut - Harku i Berdices. Ky spot eshte shperndare dhe nga Partia Socialiste Shkoder  
<https://www.facebook.com/beci.benet/videos/3285278381620619> ( postimi i Benet Beci )  
Gjithashtu nje ore me vone eshte shfaqur ky post dhe tek Partia Socialiste Shkoder. [Log in or sign up to view](#)



Log in or sign up to view

See posts, photos and more on Facebook.

Ju lutem na informoni nese u moren apo nuk u moren ne shqyrtim ankesat tonat dhe vendimet perkatесе. Pasi na duhet ti analizojme

Ju faleminderit

Fimn

